

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyrat financiare dhe treguesit e Grupit Raiffeisen

Periudha e Raportimit: 30/6/2021

Sipas kërkesave të Rregullores Nr. 4, datë 1.2.2017
“Për mbikqyrjen e konsoliduar”
te Bankës së Shqipërisë

PERMBAJTJA:

Faqe

1.	Bazat e përgatitjes dhe Përmbledhje e Politikave Kontabel	1 - 6
2.	Treguesit e rentabilitetit	7
3.	Bilanci kontabël (aktiv-pasivët) dhe zërat jashtë bilancit	8 - 9
4.	Pasqyra e llogarisë “të ardhura dhe shpenzime”	10
5.	Struktura e kapitalit rregullator	11
6.	Mjaftueshmëria e Kapitalit	12

Tiranë, më 13/08/2021

1. HYRJJE

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit përgatiten në përputhje kërkesat e rregullores nr. 4, datë 01.2.2017 "Për Mbikëqyrjen e Konsoliduar" të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë Raiffiesen Bank sh.a. dhe filialin e saj Raiffeisen Leasing Sh.a., por duke përjashtuar filialin - Raiffeisen INVEST, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. – sipas percaktimit që është bërë në nenin 5, pika 4(b) në këtë rregullore.

Raiffeisen Bank Sh.a., më poshtë referuar "Banka" është një institucion bankar i cili vepron në përputhje me Ligjin 9901, datë 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe Ligjin 9662, datë 18 Dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe me ligjet e tjera të rëndësishme. Banka është themeluar dhe vendosur në Shqipëri dhe zhvillon aktivitetin e saj operativ në Shqipëri. Raiffeisen Bank Sh.a. është bijë 100% e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri, e cila është pala kontrolluese finale.

Aktiviteti kryesor. Aktivitetet kryesore të biznesit të Grupit janë operacionet bankare me pakicë, ofrimi i qirave financiare për shoqëritë dhe individët dhe grumbullimin dhe investimin e fondeve të pensioneve vullnetare brenda Republikës së Shqipërisë.

Grupi vepron nëpërmjet një rrjeti prej 74 vendodhjesh shërbimi më 30 Qershor 2021 (31 Dhjetor 2020: 74 vendodhje shërbimi) në të gjithë Shqipërinë, të cilat administrohen në 6 distrikte dhe nuk ka aktivitete jashtë shtetit.

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare" ("Metodologjia e Raportimit Financiar" ose "MRF") e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008 si dhe të rregullores "Për Mbikëqyrjen e Konsoliduar" i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më datë 1 shkurt 2017.

MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lekë Shqiptar ("Lek"), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme që vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut si edhe ndërtesave që mbahen me vlerë të drejtë, të rivlerësuar.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Baza e konsolidimit

Konsolidimi i rezultatit financiar të Bankës me atë të Filialeve, në të cilin ka 100 për qind të aksioneve dhe politikat financiare të së cilës ushtron kontroll, bëhet duke ndjekur metodën e konsolidimit të plotë.

Të gjitha llogaritë e aktiveve, detyrimeve dhe pasqyrës së të ardhurave konsolidohen plotësisht me llogaritë e të njëjtës natyrë të Bankës. Transaksionet midis Bankës dhe Filialeve eliminohen gjatë konsolidimit të pasqyrave.

Banka dhe të gjitha filialet përdorin politika kontabiliteti uniforme dhe konsistente me politikat e Grupit. Sipas natyrës së aktivitetit, filialet e Grupit kanë disa politika kontabël specifike të cilat detajohen në shënimin 3.6 për Raiffeisen Leasing sh.a.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

(i) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe prezantuese e Grupit.

(ii) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e kryera në monedha të huaj janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Diferenca nga Rivleresimi në Kapital.

Kurset e këmbimit që janë aplikuar për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	30 Qershor 2021	31 Dhjetor 2020
Dollari Amerikan (USD)	103.10	100,84
Monedha Europiane (EUR)	122.67	123,70

3.3 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Për të raportuar fluksin e parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si: arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë ("Banka Qëndrore").

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

3.4 Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Të gjithë instrumentet financiare fillimisht regjistrohen në kosto, e cila përbëhet nga vlera e drejtë e pagesës së dhënë duke përfshirë kostot e blerjes së instrumenteve financiare. Të gjithë fitimet apo humbjet e realizuara apo të përlllogaritura janë përfshirë në të ardhurat neto.

Letrat me vlerë, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktueshme synohen të mbahen deri në maturim. Ato përfaqësojnë bonot e thesarit dhe bonot qeveritare të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Pas regjistrimit fillestar, letrat me vlerë të mbajtura për maturim, mbahen me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësime në vlerë. Amortizimi vjetor i zbritjeve apo i primeve për blerjen e letrave me vlerë të mbajtura për maturim i bashkohet të ardhurave të tjera nga investimi gjatë gjithë afatit të instrumentit në mënyrë që të ardhurat e njohura në çdo periudhë të përfaqësojnë të ardhura konstante nga letrat me vlerë.

3.4 Investime në letra me vlerë (vazhdim)

(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iii) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përlllogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iv) Vlera e drejte

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuarra të tregut, ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Grupi përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet dhe swap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të filla instrumenta, të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg. Përcaktimi i vlerës së drejtë detajohet në Shënimin 29 "Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare".

(v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje riblerjeje të anasjellta) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përlllogaritur. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes bëhen me Bankën e Shqipërisë.

3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Grupi i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Grupi dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjonet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjoneve të përgjithshme, një provigjon për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Grupi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer.

Politika huadhënëse e Grupit është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë" miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 14 korrik 2004, ndryshuar me Vendimin Nr.101, datë 27 dhjetor 2006, ndryshuar me Vendimin Nr. 31, datë 30 prill 2008, ndryshuar me Vendimin Nr. 59 dhe Nr. 61, datë 29 gusht 2008 dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 47, datë 10 qershor 2009, ndryshuar me Vendimin Nr. 62 datë 14 shtator 2014 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë).

3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Grupi e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjoneve:

Kategoria e huasë	Provigjoni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjonin për huatë e këqija; shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Grupi nuk përlogarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbartur e huave, për të cilat nuk përlogaritet interes, përfaqëson shumën për t'u marrë minus provigjonin për humbjet e pritshme. Provigjoni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t'u marrë.

3.6 Qiraja financiare

Një qira klasifikohet si qira financiare nëse ajo transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi, dhe kështu arkëtimet e qirasë së pagueshme janë trajtuar nga Grupi si shlyerje të principalit dhe të të ardhurës financiare për të rimbursuar dhe shpërblyer investimin dhe shërbimin e Grupit. Çdo marrëveshje tjetër qiraje, përveç qirasë financiare klasifikohet si qira e zakonshme.

Shumat për t'u marrë nga qiramarrësit njihen si të arkëtueshme me vlerën e investimit neto të Grupit në qiranë financiare.

Kostot fillestare të drejtpërdrejta bëra nga Grupi janë të përfshira në matjen fillestare të qirasë financiare të arkëtueshme dhe për të zvogëluar sasinë e të ardhurave të njohura gjatë afatit të qirasë. Norma e interesit e nënkuptuar në qira është përcaktuar në mënyrë të fillë që kostot fillestare të drejtpërdrejta përfshihen automatikisht në qiranë financiare të arkëtueshme, nuk ka nevojë të shtoni ato veç e veç.

E ardhura financiare shpërndahet në çdo periudhë gjatë jetës së qirasë në mënyrë që të prodhohë normë interesi konstante mbi shumën e mbetur të aktivit. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, janë aplikuar kundër investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin ashtu edhe të ardhurën financiare të pafitur.

Pagesat minimale të qirasë nën qiratë financiare shpërndahen ndërmjet të ardhurave financiare dhe reduktimit të aktiveve të mbetura.

Pagesat e mundshme të qirasë kontabilizohen duke rishikuar minimumin e pagesave të qirasë mbi jetën e mbetur të qirasë kur konfirmohen rregullimet.

3.7 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara

Prona, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara

Toka dhe ndërtesa shprehen me vlerë të rivlerësuar minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, ndërsa aktivet e tjera shprehen me kosto historike minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

3.7 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (vazhdim)

Zhvlërësimi dhe amortizimi janë paraqitur si pakësim i kostos së pronës, pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim, dhe duke aplikuar përqindjet e zhvlërësimit dhe amortizimit si më poshtë:

Kategoria	Normat e amortizimit
Ndërtesa	20 vjet
Automjete	7 vjet
Kompjutera dhe pajisje informatike	4 deri në 7 vjet
Software dhe Licenca	8 vjet
Makineri dhe sisteme	7 vjet
Pajisje për zyre dhe mobilje	5 deri në 7 vjet
Përmirësimet e objekteve me qira	1 deri në 10 vjet

Toka dhe punimet në proces nuk zhvlërësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

3.8 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

3.9 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

3.10 Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përllogaritjeje.

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

3.11 Shpenzimet

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

(ii) Përfitimet e punonjësve

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Banka derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitimim e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën individuale të të ardhurave kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

3.11 Shpenzimet (vazhdim)

(iii) Përmirësimi i ambjenteve me qira

Përmirësimi i ambjenteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambjenteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

3.12 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin më 30 Qershor 2021 llogaritet 15% (31 dhjetor 2020: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

3.13 Pjesëmarrje në filial

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë rezultatin e Raiffeisen Leasing Sh.a. dhe nuk përfshijnë rezultatin dhe aktivet neto të Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. Investimi në këtë filial është raportuar me kosto.

3.14 Vlerësimi i vlerës së tregut

Duke qenë se për instrumentat financiare të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të instrumentave të ndryshëm financiarë dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat me vlerë shqiptare.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiare të bilancit individual ekzistues pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara.

Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit individual të Grupit kanë një vlerë të vlerësuar tregu afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrojnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë, ose kanë norma interesi të luhatshme, ose riçmohen brenda vitit.

3.15 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me MRF dhe Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në paraqitjen e vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

3.16 Krahasueshmëria

Politikat kontabël të adoptuara nga Grupi janë konsistente me ato të paraqitura një vit më parë, përveçse kur theksohet ndryshe.

Treguesit e rentabilitetit të Grupit Raiffeisen

Treguesit e rentabilitetit*	30/06 2021	31/03 2021	31/12 2020	30/09 2020	30/06 2020
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) = të ardhurat neto / aktivet mesatare *100;	1.2%	1.5%	0.9%	0.9%	0.9%
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;	0.1%	0.2%	0.2%	0.3%	0.2%
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	28.5%	31.9%	31.1%	30.7%	31.1%
4. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar *100;	9.0%	11.0%	6.6%	6.6%	6.5%
5. Aktive për punonjës: = totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve;	194,919	191,595	187,699	184,303	177,161
6. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	13.5%	15.0%	16.1%	15.7%	15.9%

(*) Treguesit janë llogaritur sipas kërkesave të Rregullores Nr. 4, datë 1.2.2017 "PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR".

Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilanci te Grupit Raiffeisen

Aktivët në mijë Lekë	30/06 2021	31/12 2020	Ndryshimi YTD absolut	Ndryshimi YTD ne %	30/06 2021	31/03 2021	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Arka dhe Banka Qëndrore	45,455,278	61,545,913	(16,090,635)	-26.1%	45,455,278	53,333,311	(7,878,033)	-14.8%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	8,677,438	4,581,552	4,095,886	89.4%	8,677,438	7,844,093	833,345	10.6%
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	31,108,446	20,819,670	10,288,776	49.4%	31,108,446	32,941,391	(1,832,945)	-5.6%
Hua dhe paradhënie neto për klientët	91,946,874	91,660,507	286,367	0.3%	91,946,874	89,237,306	2,709,568	3.0%
Letra me vlerë	66,656,654	55,908,475	10,748,179	19.2%	66,656,654	56,363,631	10,293,023	18.3%
Investime në filiale	109,648	109,648	0	0.0%	109,648	109,648	0	0.0%
Mjetet e trupëzuara	3,269,961	3,368,955	(98,994)	-2.9%	3,269,961	3,304,992	(35,031)	-1.1%
Mjetet e patrupëzuara	1,444,655	1,465,668	(21,013)	-1.4%	1,444,655	1,437,251	7,404	0.5%
Mjete të tjera	2,386,444	3,047,131	(660,687)	-21.7%	2,386,444	2,394,664	(8,220)	-0.3%
Totali aktiveve	251,055,398	242,507,520	8,547,878	3.5%	251,055,398	246,966,285	4,089,113	1.7%
DETYRIMET në mijë Lekë	30/06 2021	31/12 2020	Ndryshimi YTD absolut	Ndryshimi YTD ne %	30/06 2021	31/03 2021	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore	0	0	0	0.0%	0	0	0	0.0%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	0	0	0	0.0%	0	0	0	0.0%
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç B.Qëndrore	6,453,348	5,684,959	768,389	13.5%	6,453,348	8,192,560	(1,739,212)	-21.2%
Detyrimet ndaj klientëve	206,882,495	197,849,142	9,033,353	4.6%	206,882,495	201,146,704	5,735,791	2.9%
Detyrimet ndaj qeverisë dhe organizatave publike	360,375	351,732	8,642	2.5%	360,375	356,525	3,850	1.1%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	1,473,233	1,501,382	(28,149)	-1.9%	1,473,233	1,717,868	(244,636)	-14.2%
Fonde rezervë për reziqe dhe shpenzime	1,150,681	1,069,041	81,641	7.6%	1,150,681	1,063,956	86,726	8.2%
Borxh i varur	0	0	0	-	0	0	0	-
Tatimi fitimi për t'u paguar	181,346	70,036	111,310	158.9%	181,346	36,372	144,974	398.6%
Detyrime të tjera	2,676,430	2,588,458	87,972	3.4%	2,676,430	3,058,421	(381,992)	-12.5%
Kapitali aksionar	31,877,492	33,392,770	(1,515,279)	-4.5%	31,877,492	31,393,880	483,611	1.5%
Kapitali i paguar	14,178,593	14,178,593	0	0.0%	14,178,593	14,178,593	0	0.0%
Rezerva	5,049,753	5,094,967	(45,213)	-0.9%	5,049,753	5,072,360	(22,607)	-0.4%
Diferenca e rivlerësimit	(1,862,792)	(1,759,382)	(103,410)	5.9%	(1,862,792)	(1,813,597)	(49,195)	2.7%
Fitimi (humbja) i pashpërndarë	13,073,435	13,735,603	(662,168)	-4.8%	13,073,435	13,073,435	(0)	0.0%
Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	1,438,502	2,142,990	(704,488)	-32.9%	1,438,502	883,089	555,413	62.9%
Interesa të pakicës	0	0	0	-	0	0	0	-
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	251,055,398	242,507,520	8,547,878	3.5%	251,055,398	246,966,285	4,089,113	1.7%
Zërat jashtë bilanci mijë Lekë	30/06 2021	31/12 2020	Ndryshimi YTD absolut	Ndryshimi YTD ne %	30/06 2021	31/03 2021	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Angazhime dhe garanci të dhëna	25,728,215	23,562,326	2,165,889	9.2%	25,728,215	26,715,145	-986,930	-3.7%
Angazhime garanci të marra	1,982,463	1,803,752	178,711	9.9%	1,982,463	1,923,789	58,674	3.0%
Transaksione në valutë	0	0	0	-	0	0	0	-
Angazhime të tjera	0	0	0	0%	0	0	0	0%

Shenimi: Shifrat janë të pa audituara nga auditoret e jashtëm

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	1/1-30/06 2021	1/1-30/06 2020	Ndryshimi YoY absolut	Ndryshimi YoY ne %	Tremujori-2 2021	Tremujori-1 2021	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Të ardhurat nga interesat	2,372,800	2,453,598	(80,798)	-3.3%	1,188,974	1,183,826	5,147	0.4%
Shpenzimet për interesa	(33,583)	(84,531)	50,948	-60.3%	(16,794)	(16,789)	(5)	0.0%
Te Ardhurat Neto nga Interesat	2,339,217	2,369,067	(29,850)	-1.3%	1,172,180	1,167,038	5,142	0.4%
Të ardhura nga operacionet financiare	1,187,789	936,177	251,612	26.9%	737,835	449,954	287,881	64.0%
Humbje nga operacionet financiare	(86,638)	(44,296)	(42,342)	95.6%	(51,703)	(34,935)	(16,768)	48.0%
Fitimi neto nga veprimet financiare	1,101,151	891,880	209,270	23.5%	686,131	415,019	271,112	65.3%
Te ardhurat nga komisionet	1,596,889	1,366,599	230,290	16.9%	820,125	776,764	43,361	5.6%
Shpenzime per komisionet	(598,636)	(482,312)	(116,324)	24.1%	(308,749)	(289,887)	(18,861)	6.5%
Fitimi Neto nga Komisionet	998,253	884,287	113,965	12.9%	511,376	486,876	24,500	5.0%
Të ardhurat nga veprimet e qirasë, neto	2,909	(762)	3,671	-481.7%	(237)	3,146	(3,383)	-107.5%
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare, neto	(291,180)	(271,504)	(19,676)	7.2%	(92,039)	(199,141)	107,102	-53.8%
Fitime nga veprimet me valutat, neto	340,782	251,235	89,548	35.6%	144,452	196,330	(51,878)	-26.4%
Të ardhura neto nga veprimtaria bankare	4,491,131	4,124,204	366,928	8.9%	2,421,864	2,069,268	352,596	17.0%
Shpenzime për personelin	(1,108,262)	(1,240,093)	131,831	-10.6%	(554,923)	(553,339)	(1,583)	0.3%
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	(28,794)	(38,545)	9,751	-25.3%	(17,995)	(10,799)	(7,197)	66.6%
Shpenzime të përgjithshme administrative	(1,206,055)	(1,140,290)	(65,764)	5.8%	(591,661)	(614,394)	22,733	-3.7%
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(2,343,111)	(2,418,929)	75,818	-3.1%	(1,164,579)	(1,178,532)	13,953	-1.2%
Të ardhurat e veprimtarisë përpara shpenzimeve për amortizime dhe për fonde rezervë	2,148,021	1,705,275	442,746	26.0%	1,257,285	890,736	366,549	41.2%
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	(242,985)	(235,578)	(7,407)	3.1%	(122,042)	(120,943)	(1,099)	0.9%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fondet rezervë statistikore	(92,674)	27,782	(120,456)	-433.6%	(95,008)	2,334	(97,342)	-4170.4%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	187,890	(296,942)	484,832	-163.3%	36,571	151,319	(114,749)	-75.8%
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	(324,978)	(42,612)	(282,367)	662.6%	(304,486)	(20,492)	(283,994)	1385.9%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde të tjera rezervë	(886)	(155,476)	154,590	-99.4%	(34,295)	33,409	(67,704)	-202.7%
Fitimi neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme	109,935	205,726	(95,791)	-46.6%	8,934	101,001	(92,067)	-91.2%
Fitimi (Humbja) para tatimit	1,784,322	1,208,174	576,148	47.7%	746,959	1,037,364	(290,405)	-28.0%
Taksa mbi të ardhurat	(345,820)	(176,450)	(169,370)	96.0%	(191,546)	(154,275)	(37,271)	24.2%
Fitimi / (Humbja) neto per periudhen	1,438,502	1,031,724	406,778	39.4%	555,413	883,089	(327,676)	-37.1%

Shenimi: Shifrat jane te pa audituara nga auditoret e jashtem

Struktura e kapitalit rregullator për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	30/6/2021
KAPITALI RREGULLATOR	27,132,123
KAPITALI I NIVELIT TE PARE	27,132,123
KAPITALI BAZE I NIVELIT TE PARE	27,132,123
Instrumenta të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)	14,178,593
Kapitali i paguar	14,178,593
Primet e aksioneve	-
Fitimet e pashpërndara	13,073,435
Fitimet e pashpërndara të mbartura nga periudhat e mëparshme	13,073,435
Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	-
Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	-
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	3,297,190
Diferenca rivlerësimi (debitore)/ kreditore	(1,862,792)
Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë	0
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	(1,444,655)
(-) Instrumenta të KBN1 ku banka ka investimeve të rëndësishme	(109,648)
(-) Shuma që tejkalon kufirin prej 17.65%	0
KAPITALI SHITESI I NIVELIT TE PARE	-
KAPITALI I NIVELIT TE DYTE	-
Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si KN2	-
Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur	-

Raportet dhe nivelet e kapitalit për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	Kufijtë	Vlera
Kapitali rregullator	> 1.000.000	27,132,123
Kapitali i nivelit të parë	> 1.000.000	27,132,123
Kapitali bazë i nivelit të parë	> 1.000.000	27,132,123
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	N/A	115,477,150
Raporti i Mjafueshmërisë së Kapitalit (në %)	≥ 12%	23.50
Raporti: Kapitali i nivelit të parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun (në %)	≥ 9%	23.50
Raporti: Kapitali bazë i nivelit të parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun (%)	≥ 6.75%	23.50

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	30/6/2021
KAPITALI RREGULLATOR	27,132,123
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit - RMK - (%) $\geq 12.0\%$	23.50
SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK	115,477,150
RREZIKU I KREDISE	
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	96,769,171
Klasat e ekspozimit sipas SA duke përfshirë pozicionet e titullimit	96,769,171
Ekspozime ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	7,748
Ekspozime ndaj organizatave joqeveritare / jofitimprurëse;	0
Ekspozime ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	6,987,434
Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	45,210,153
Ekspozime ndaj portofoleve me pakicë (retail);	28,968,803
Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	2,611,025
Ekspozime (kredi) me probleme;	4,261,330
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	2,932,978
Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	740,367
Zëra të tjerë	5,049,331
Pozicionet e titullimit SA	0
RREZIQET E TREGUT	
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	907,683
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	0
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	907,683
Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	612
Rreziku i kursit të këmbimit	907,072
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm	0
RREZIKU OPERACIONAL	
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	17,800,295
Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	0
Metoda Standarde / Standarde Alternative	17,800,295
Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	0